



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të neneve 11, 12 par.12.2 shkronja c), 16 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27 e datës 03.06.08 si dhe neneve 9 , 17 dhe 18 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e datës 28.03.2013 , miratoi këtë

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E QIRASË PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË TOKËS
BUJQËSORE, BANESAVE DHE LOKALEVE AFARISTE NË PRONËSI TË KOMUNËS
SË LIPJANIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i miratimit të Rregullores për përcaktimin e qirasë për dhënie në shfrytëzim të tokës bujqësore, banesave dhe lokaleve afariste në pronësi të Komunës së Lipjanit (në vazhdim të tekstit: Rregullore) është që Komuna të krijoj burime të të hyrave vetanake në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal.

Neni 2
Objekti i rregullimit

1. Me këtë Rregullore përcaktohet lartësia e qirasë për shfrytëzimin e pronës komunale – tokave, banesave dhe lokaleve afariste sipas procedurave ligjore për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Komunës.

2. Të hyrat nga qiraja për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale nga neni praparak janë të hyra buxhetore të Komunës.

Neni 3
Përcaktimi i qirasë për dhënie në shfrytëzim të tokës bujqësore

1. Shuma e qirasë për dhënie në shfrytëzim të tokës bujqësore në pronësi të Komunës në pajtim me këtë Rregullore përcaktohet në bazë vjetore në kontratat e lidhura në pajtim me dispozitat materiale dhe procedurale për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, në bazë të bonitetit të klasës së tokës në shumat e përcaktuara në tabelat në vijim:

a) Lartësia e qirasë për dhënie në shfrytëzim të tokës bujqësore sipas klasëve të bonitetit të tokës – në bazë vjetore

Boniteti	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII
Çmimi/1 ha	60 €	50 €	45 €	40 €	35 €	30 €	25 €	20 €

b) Lartësia e qirasë për dhënie në shfrytëzim të kullësve – në bazë vjetore

Boniteti	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII
Çmimi/1 ha	50 €	45 €	40 €	35 €	30 €	25 €	20 €	10 €

Neni 4

Përcaktimi i qirasë për dhënie në shfrytëzim të banesave dhe lokaleve afariste

1. Shuma e qirasë për dhënie në shfrytëzim të banesave dhe lokaleve afariste në pronësi të Komunës në pajtim me këtë Rregullore përcaktohet në bazë mujore në kontratat e lidhura në pajtim me dispozitat materiale dhe procedurale për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale në shumat e përcaktuara në tabelën në vijim:

Shuma e qirasë mujore për banesat dhe lokalet afariste në pronësi të Komunës

Emërtimi	Zona – Vendndodhja		
	I-rë - Çmimi/m ²	II-të - Çmimi/m ²	III-të - Çmimi/m ²
banesë	1.5 €	1 €	0.70 €
lokal afarist	4 €	3 €	2 €

2. Zona - Vendndodhja e banesave dhe lokaleve afariste në pronësi të Komunës nga neni paraprak përfshijnë zonën – vendndodhjen ashtu siq janë të përkufizuara në Rregulloren Komunale mbi tatimin në Pronë.

Neni 5

1. Për inkasimin e të hyrave në bazë të kontratave të lidhura për dhënie me qira të pronës komunale sipas shumave të përcaktuara në nenin 3 dhe 4 të kësaj Rregulloreje do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

2. Drejtorati për Buxhet dhe Financa në perioda tre mujore gjatë vitit kalendarik do të informojë Kryetarin e Komunës për dinamikën e realizimit të këtyre të hyrave si dhe me listen e kontraktuesve të cilët nuk i kanë përmbush obligimet nga qiraja.

VI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 6 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës dhe në Tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës, ndërsa do të aplikohet duke filluar nga 01.01.2013.

15 Nr. - 464-4251
Lipjan, më 12-03-2013

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



KRYESUESI I KUVENDIT
Lulzim Rrustemi